



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**PSH. Nr. 412/23**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga : Vedat Poterqoi - Kryetar Kimete Gashi - Anëtar, Agon Ramadani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "Gjeokonsult&CO", me seli në Tiranë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës", me numër të prokurimit 616-22-7431-3-1-2, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Kuvendi i Komunës së Prishtinës, me datën 26.06.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

1. Hedhet si e palejuar ankesa e OE "Gjeokonsult&CO", me nr. 2023/0412, e datës 19/06/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës me numër të prokurimit 616-22-7431-3-1-2, iniciuar nga AK-Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

2.1 Lejohet, autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës që të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës" me numër të prokurimit: 616-22-7431-3-1-2.

3. Bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## Arsyetim

### *- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 09.03.2023, Komuna e Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Rezultatet e Pjesës Teknike për aktivitetit të prokurimit me titull: “Konsulencë për themelimin e Shërbimit të Arkitektit të Kryeqytetit për nevojat e Komunës së Prishtinës”, me numër të prokurimit 616-22-7431-3-1-2.

Me datë 14.03.2023, Operatori Ekonomik “Gjeokonsult&CO”, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK- Kuvendi i Komunës së Prishtinës, me datë 20.03.2023 AK e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e OE ankues dhe e ka vërtetuar njoftimin mbi rezultatet e pjesës teknike të publikuara nga AK me datë 09.03.2023. Kjo pasi që nuk ka arritur të kaloj minimumin e pikëve të propozimit teknik si kusht i Dosjes së Tenderit.

Me datën 24.03.2023 Operatori Ekonomik “Gjeokonsult&CO”, në fazën e dytë ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 161/2023, kundër vendimit të AK lidhur me Njoftimit mbi Rezultatet e Pjesës Teknike,

Me dt. 22.05.2023, lidhur me këtë ankesë të paraqitur, OSHP nxjerr vendimin me Nr. 161/2023, duke e lejuar AK që të vazhdoj me procedurat e mëtutjeshme të prokurimit.

Me datën 31.05.2023, AK Komuna e Prishtinë ka publikuar njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues me pikët e pjesës teknike dhe financiare dhe duke rekomanduar fituesin.

Me datë 05.06.2023, Operatori Ekonomik “Gjeokonsult&CO”, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK- Komuna e Prishtinës, me datë 09.06.2023, ku e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e OE ankues dhe duke e trajtuar edhe si palë pa interes sipas nenit 4.1.26, ngase OE nuk ka arritur pikët minimale të propozimit teknik dhe për këto rezultate ka pasur njoftim dhe oferta e OE nuk ka qenë dashtë të trajtohej tutje nga Komisioni i Vlerësimit sipas nenit 48 të RRUOPP.

Me datën 19.06.2023 Operatori Ekonomik “Gjeokonsult&CO”, ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 412/2023, kundër vendimit të AK të lëshuar me 09.06.2023.

### *- Administrimi dhe vlerësimi i provave -*

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, po ashtu edhe në kuptim të nenit 16 dhe 17 të kësaj rregulloreje, analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin

e ekspertit dhe konsideron se janë jo kontestuese faktet se AK ka zbatuar në këtë aktivitet të prokurimit procedurën e kufizuar, vlerë e madhe, lloji i kontratës shërbime këshilluese, vlera e parashikuar 12,000,000.00 €..

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit dhe mos prolongimin e mëtejme të këtij procesi të prokurimit, si dhe duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me 6 të nenit 108/A dhe në 109 të LPP-së, lidhur me pika 9 paragrafi 1 te nenit 111 dhe nenit 104.4 te LPP-së dhe njëherit duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur sqarimeve të marra nga AK me datën 19.06.2023 për ankesën në fjalë e cila është paraqitur në OSHP dhe e cila nuk duhet të vihet në shqyrtim të rregullt procedura për shkak se OE ankues nuk e ka epitetin e palës me interes, andaj PSH ka konstatuar se nuk qëndron nevoja e angazhimit të ekspertit shqyrtues për shkak se pretendimet ankimore nuk mund të trajtohen, kështu që duke u bazuar në tiparet themelore të LPP, siç janë efikasiteti, ekonomiciteti dhe trajtimi i barabartë dhe kohës së inicimit të këtij aktivitetit të prokurimit që nga data 21.07.2022, Paneli konstatoi në vijim se:

Procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është trajtuar në dy raste tjera nga kjo përbërje e panelit shqyrtues, në bazë të ankesave të parashtruara në OSHP. Në fazën e parë me vendimin të PSH nr.44/23, Në fazën e dytë sa i përket propozimeve teknike me vendimin të PSH nr. 161/23. Për të cilën janë prezantuar në detaje në raportet e ekspertëve shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me RROUPP.

Sikurse mund të kuptohet edhe nga përmbajtja e ankesës, apriori pretendimet ankimore nuk konsistojnë në faktin nëse është atakuar apo jo interesi ekonomik i Ankuesit (Operatori Ekonomik “Gjeokonsult&CO”) por ato atakojnë shkaqet dhe arsyet mbi bazën e të cilave AK, ka rekomanduar për kontratë një tjetër OE. Prandaj parashtruesi i ankesës nuk mund ta ketë tani në këtë fazë statusin e palës me interes në kuptim të paragrafit 1.26, të nenit 4 (Përkufizimet), të LPP, sipas të cilit palë e interesuar është personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit. Andaj, si rrjedhojë e fakteve dhe rrethanave të përshkruara shkurtimisht si më sipër, Paneli konsideron se tani në këtë fazë të përmbylljes së aktivitetit të prokurimit, pretendimet ankimore janë jo relevante, përderisa i njëjti nuk ka arritur ta dëshmojë statusin e një OE të përgjegjshëm sikurse kërkohet me nenin 60 (Kriteret për Dhënien e Kontratës) të LPP. Ngase në kërkesa të Dosjes së Tenderit ka qenë që “Nota teknike minimale Nt që kërkohet për të kaluar është 80 nga 100 pikë të mundshme.” Për shkak të mos arritjes së këtyre pikëve OE ankues ju është hapur mundësi për kërkesë për ri-shqyrtim në AK dhe pastaj ankesë në OSHP, dhe këtë mundësi OE ankues e ka shfrytëzuar dhe si rezultat është prodhuar vendimi i PSH Nr. 161/23 i datës 22.05.2023.

Në kontekstin shpjegimeve si më sipër, Paneli e klasifikon si të drejtë vendimin e AK mbi refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim duke e klasifikuar si palë pa interes OE ankues, duke ju

referuar nenit 4.1.26 të LPP, mbi bazën e veprimit konform dispozitave ligjore, përkatësisht nenit 48 të RRUOPP (pa pasur nevojë që ato të përsëriten).

PSH e vuri në zbatim po ashtu nenin 103, të LPP, sipas të cilit, “Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion të palëve të interesuara siç është përkufizuar ky term (“palë e interesuar”) në nenin 4 të këtij ligji”. Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e këtij Paneli se, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga palët e interesuara duke ju referuar në këtë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4, të LPP.

Prandaj bazuar në kuptimin e nenit 4, të LPP, lidhur me nenin 103 dhe 111, të këtij Ligji, Paneli konsideron se parashtruesi i saj nuk mund të konsiderohet palë e interesuar dhe se nuk ka nevojë të lëshohet në vlerësimin meritore të pohimeve specifike të kësaj Ankese, sepse të njëjtat janë jo lëndore në kuptim të neni 111, të LPP.

Nga faktet e prezantuara si më lart paneli konstaton se ankesa e Operatori Ekonomik “Gjeokonsult&CO” e datës 19.06.2023 (protokoll 412/2023), e parashtruar në OSHP nuk përmban edhe kushtet për tu shqyrtuar. Ndërsa, është përgjegjësi e AK Komuna e Prishtinës për respektimin e dispozitave ligjore të LPP dhe akteve tjera në fuqi për vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e ofertave konform këtyre akteve.

Prandaj Paneli konsideron se faktet e cituara si më sipër kanë efekt qenësor lidhur me marrjen e vendimit të AK, sepse:

- Është aplikuar kriterit *Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht* më i favorshëm, sikurse kërkohet shprehimisht me dispozitën e nenit 52 të LPP, sipas të cilit, cituar: “Autoriteti kontraktues në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit do të specifikoj kriteret që do të përdoren për dhënie të kontratës. Kriteret duhet të jenë ose çmimi më i ulët ose tenderi ekonomikisht më i favorshëm”.

- AK ka vepruar në pajtim me nenin 59 të LPP, sepse nuk ka aplikuar ndonjë ndryshim material në dosjen e tenderit sikurse parashihet me paragrafin 2, të nenit të cituar sipas të cilit “Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues”.

- AK ka zbatuar drejtë nenin 60 të LPP, sipas të cilit “Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kriterëve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 të këtij ligji”.

*- Përfundim -*

Nisur nga shpjegimet si më sipër Paneli konsideron se AK ka vepruar në harmoni me dispozitat e cituara si më sipër të LPP dhe ka zbatuar drejtë dosjen e tenderit sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 27, sipas të cilit, autoriteti kontraktues përpilon dosjen e tenderit me të gjitha informatat

përkatëse përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. Në kuptim të kësaj dispozite, dosja e tenderit përbën dokumentin kryesor të prokurimit dhe se publikimi i sajë supozohet të jetë në harmoni të plotë me qëllimet e LPP, të siguroj mënyrën efikase të shfrytëzimit të fondeve publike, të promovoj integritetin e vet procesit të prokurimit dhe të kulturës institucionale dhe të profesionalizuar.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrë në këtë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese. Paneli Shqyrtues nisët gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në detyrimin e tyre eksplicit respektimi i ligjshmërisë në procesin e prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi



#### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur ka të drejtë që t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë në afat prej 30 ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.

#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- AK-Komuna e Prishtinës
- OE ankues
- Arkivës së OSHP-së;
- Për publikim në ueb-faqe zyrtare;